



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË / OSNOVNI SUD MITROVICA

AD.GJTHM.nr.07/23

GJYKATA THEMELORE MITROVICE, Nënkryetari i Gjykatës Bekim Veliqi, duke vendosur në çështjen disiplinore të ngritur ndaj Xh.J, Gjyqtar pranë Gjykatës Themelore Mitrovicë-Departamenti i përgjithshëm, duke vepruar sipas ankesës disiplinore të parashtruar nga pala N.B, pas vlerësimit të ankesës së parashtruar nga i njëjti dhe pranimi të deklaratës së Gjyqtarit Xh.J, në vlerësim të shkresave të lëndës, në mbështetje të nenit 9 par.6 të Ligjit mbi përgjegjësitë disiplinore të gjyqtarëve dhe prokuror dhe nenit 7 par.3 pika 3.1 dhe 3.2 të Rregullores për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve, me datë 24.08.2023, merre këtë;

A K T V E N D I M

REFUZOHET Ankesa disiplinore e dt.03.08.2023, e regjistruar me numër të lëndës AD.GJTHM.nr.07/2023, e parashtruar nga pala N.B me vendbanim në rr.“...”, ..., kundër Gjyqtarit Xh.J, Gjyqtar në Gjykatën Themelore Mitrovicë – Departamenti i Përgjithshëm, e **PA BAZUAR**.

A r s y e t i m

Në cilësinë e autoritetit kompetent të Gjykatës Themelore në Mitrovicë ne rrethanat aktuale, me dt.03.08.2023 kemi pranuar ankesën nga pala N.B me vendbanim në rr.”...” ..., kundër Xh.J, Gjyqtar në Gjykatën Themelore Mitrovicë-Departamenti i përgjithshëm, e cila ankesa fillimisht i është drejtuar Këshillit Gjyqësor të Kosovës me dt.01.08.2023.

Pala N.B në ankesë thekson vrejttjet, shqetësimet dhe pretendime e tij në lidhje me ecurinë e seancave gjyqësore si dhe në mënyrën e vendosjes së çështjes nga ana e gjyqtarit Xh.J, sepse gjatë seancës gjyqësore të mbajtur në muajin korrik 2023, avokati M.H si mbrojtësi i të akuzuarës T.M e akuzuar për veprën penale Keqtrajtim gjate ushtrimit detyrës zyrtare, avokati në fjalë gjatë seancës ka lëshuar fjalë të ndryshme në prezencën e palëve, e ndër tjera Prokurores A.Z i është drejtuar me fjalët „*a je shit ti hala apo a shitesh*”, ku gjyqtari nuk i ka tërheq vërejtjen avokatit, as nuk ka reaguar fare, po ashtu ka theksuar se ka vërejtje edhe lidhur me dënimet e shqiptuar ndaj të akuzuarve, me tutje ka shtuar qe lëndët të largohen nga ky gjyqtar dhe kjo gjykate të gjitha lëndët në emër të N.B të transferohen jashtë regjionit të Mitrovicës.

Autoriteti kompetent në rastin konkret ka marrë veprime procedurale pas pranimi të ankesës, ka iniciuar procedurën disiplinore ndaj subjektit të hetimit-gjyqtarit i cili ka dhënë deklaratë me shkrim lidhur me ankesën e palës N.B duke theksuar se nga hapja e shqyrtimit gjyqësor e deri në përfundimin e tij nga asnjë palë nuk janë përdore shprehjet e apostrofuara nga ana e të dëmtuarit, për këtë i referohet procesverbaleve të shqyrtimit gjyqësor të cilat janë të nënshkruara pa vërejtje nga ana e palëve. Sa i përket pa kënaqësive të palëve lidhur me vendim e gjykatës, palët kanë të drejtë e tyre në ankesë.

Ndërsa sa i përket pretendimit të palës së dëmtuar siç është shprehur në ankese përveç që janë të pavërteta, i njëjti gjatë gjithë kohës në cilësinë e palës së dëmtuar sikurse edhe palët tjera në procedurë është trajtuar me respekt, duke respektuar personalitetin dhe dinjitetin e të njëjtëve ashtu siç përcaktohet me legjislacioni vendor dhe ndërkombëtar.

Andaj autoriteti kompetent ka konstatuar se ankesa si e tillë është e pabazuar, pretendimet për shkeljet konkret të Ligjit për Përgjegjësi disiplinore për Gjyqtar dhe Prokuror janë të pa qëndrueshme, nuk kemi dyshim të qëndrueshëm për veprimet procedurale në raport me subjektin e hetimit duke marrë për bazë përgjigjen e marrë nga gjyqtari ndaj të cilës është ngritur procedura disiplinore, i cili në mënyrë përmbajtjesore i ka shpjeguar veprimet e ndërmarra, duke cek se palët gjatë shqyrtimit gjyqësor nuk ka paraqitur vërejtje lidhur me ecurinë e seancave gjyqësore, që këtë e vërteton edhe procesverbali i nënshkruar pa vërejtje nga ana e palëve dhe asnjë propozim paraprak për përjashtimin e gjyqtarit apo edhe te gjykatës, por kërkesa vjen vetëm pasi që është përfunduar lënda dhe shpallur aktgjykimi lenden penale P.nr.661/2021.

Vërejtët e palës ankuese edhe me vendimmarrjen me rastin e shqiptimit të dënimeve palëve të pandehurve ne procedure, ku te pandehurve Rr.M i shqipton dënim me burgim prej gjashte muajve i cili dënim i zëvendësohet me dënim me gjobë ne shume prej 3000€, janë çështje që janë marre ne vlerësim të gjitha rrethanave që i vlerëson gjykata me rastin e përcaktimit të dënimit, rrethana të cilat do të arsyetohen edhe ne aktgjykim.

Pala ankuese N.B ka pasur vërejtje edhe te Aktgjykimi P.nr.557/2022, ne te cilin raste është pale e pandehur sipas Aktakuzës se parashtruar nga ana e Prokurorisë Themelore Mitrovice PP.nr.II.614/2022, ku është propozuar dhënia e Urdhrit ndëshkimor te dënimit me gjobe pa mbajtjen e seancës se shqyrtimit gjyqësor, Gjykata e ka aprovuar këtë duke i shqiptuar dënim me gjobe ne shume prej 200€, ndaj te cilit aktgjykim pala e ka te drejtën e kundërshtimit ne afat prej 8 ditësh pas pranimit te aktgjykimit.

Po ashtu ne cilësinë e palës ankuese ka theksuar që lendet te largohen nga ky gjyqtar dhe kjo gjykate, kjo kërkesë ka ardhur vetëm pasi që gjyqtari ka shpallur vendimin ne çështjen penale ndaj te pandehurve dhe nuk kemi një kërkesë paraprakisht për te vendosur sa i përket përjashtimit te gjyqtarit apo edhe te gjykatës ne tërësi ato janë veprim procedurale që merren gjatë zhvillimit te procedurës gjyqësore dhe vlerësohen, ne rastin konkret gjyqtari ka obligim që te përpiloj aktgjykimin e shpallur ne lenden P.nr.661/2021, ndaj te cilit aktgjykim palët e kane te drejtën e ankesës siç e përcaktojnë dispozitat ligjore.

Autoriteti kompetent vlerëson se pakënaqësitë e palëve te marrja e vendimit respektivisht te lartësia e dënimit si ne rastin konkret P.nr.661/2021, nuk mund të konsiderohet edhe shkelje disiplinore, ne këtë rast palët e kane te drejtën ligjore te parashtrimin te ankesës ndaj aktgjykimit për Gjykatën e Apelit ne Prishtine ne afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit te aktgjykimit per palët që lejohet ankesa, po ashtu edhe ne lenden penale ku është marre Aktgjykim P.nr.557/2022, duke i dhënë urdher ndëshkimor dënim me gjobe ne te cilin rast tani ankuesi është ne cilësinë e te pandehurit, i njeiti e ka te drejtën e ushtrimin te kundërshtimit ne afatin prej 8 ditësh, dhe nga rrethanat nuk rrjedh se kemi te bëjmë me shkelje ligjore disiplinore ne rastin konkret, andaj në bazë të gjitha këtyre ankesa disiplinore është refuzuar e pabazuar.

Nga arsyet e theksuara me larte, ne mbështetje te nenit 9 par.6 te Ligjit mbi Përgjegjësitë disiplinore te gjyqtarëve dhe prokuroret dhe nenit 7 par.3 pika 3.1 dhe 3.2 te Rregullores për Procedurën Disiplinore te Gjyqtareve, u vendos si ne dispozitiv te këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NE MITROVICE
AD.GJTHM.nr.07/2023, dt.24.08.2023

Nënkryetari i Gjykatës
Bekim Veliqi

Aktvendimi i dërgohet;

- 1. Këshillit Gjyqësor të Kosovës**
- 2. Parashtruesit te ankesës N.B**
- 3. Gjyqtarit Xh.J**